



Polytechnic University of Tirana
Institute of Geosciences
Department of Meteorology

2025
Qershor / June

BULETINI MUJOR KLIMATIK

CLIMATE MONTHLY BULLETIN

Chief Editor

Dr. Azem BARDHI

Editorial Board

Prof. Asoc. Albana HASIMI

Prof. Asoc. Elvin ÇOMO

Prof. Asoc. Enkelejda KUCAJ

PhD. Anira GJONI

PhD. (c) Gazmir ÇELA

The Editorial Advisory Board approved the Director of IGEO – Prof. Dr. Ylber MUCEKU

Ky buletin u realizua me kontributin e punonjësve të Departamentit të Meteorologjisë, Instituti i Gjeoshkencave.

This bulletin has been realized by the staff contribution of the Department of Meteorology, Institute of Geosciences.

Data control, verification & elaboration under the supervision of: Azem BARDHI, Anira GJONI and Gazmir ÇELA.

Introduction: Enkelejda KUCAJ

Agrometeorology: Enkelejda KUCAJ

Solar Radiation: Gazmir ÇELA and Anira GJONI

Synoptic Situation: Gentiana STAFA

Air temperatures: Anira GJONI

Atmospheric precipitation: Gazmir ÇELA

Data digitalization: Gentiana STAFA

Tirana, Albania © 2025 Department of Meteorology

Institute of Geosciences, PUT

Përmbajtja / Contents

4	HYRJE/ INTRODUCTION
5	RREZATIMI DIELLOR / SOLAR RADIATION
7	SITUATA SINOPTIKE / SYNOPTIC SITUATION
10	TEMPERATURAT E AJRIT / AIR TEMPERATURES
21	RESHJET ATMOSFERIKE / ATMOSPHERIC PRECIPITATION
24	AGROMETEOROLOGJI / AGROMETEOROLOGY

Buletini Mujor Klimatik Nr. 102-2025 publikohet në faqet "online" të OBM, UPT, IGEO dhe një sërë institucionesh të tjera. Për buletin mund të klikoni në të gjitha faqet përkatëse.

The Monthly Climate Bulletin No. 102-2025 is published on the "online" pages of WMO, UPT, IGEO



HYRJE

Muaji qershor 2025 u karakterizua nga kushte klimatike tipike verore, të dominuara nga temperatura të larta të ajrit, kohëzgjatje e madhe e diellzimit dhe mungesë e theksuar e reshjeve në pjesën më të madhe të territorit të Shqipërisë.

Gjatë muajit u evidentuan disa episode të valëve të të nxehtit, të lidhura me dominimin e anticiklonit subtropikal mbi rajonin e Mesdheut, të cilat sollën temperatura dukshëm mbi normën klimatike shumëvjeçare.

Në shkallë kombëtare, temperatura mesatare e ajrit rezultoi rreth $+3.8^{\circ}\text{C}$ mbi normën klimatike të periudhës 1961–1990, ndërsa temperaturat maksimale shënuan devijime edhe më të larta, me një anomali mesatare prej rreth $+5.3^{\circ}\text{C}$. Vlerat më të larta u regjistruan në ultësirën perëndimore dhe zonat jugore të vendit, ku në disa raste temperaturat maksimale absolute iu afruan 39°C . Reshjet atmosferike paraqitën deficit të theksuar, me një anomali negative prej rreth -78.7% krahasuar me normën klimatike. Numri i ditëve me reshje mbi pragun 1.0 mm ishte dukshëm më i ulët se mesatarja shumëvjeçare, duke reflektuar stabilitetin e lartë atmosferik dhe mungesën e sistemeve të organizuara ciklonike mbi rajon.

Këto kushte klimatike ndikuan drejtpërdrejt në zhvillimin e proceseve agrometeorologjike. Akumulimi i lartë i nxehtësisë dhe kohëzgjatja e madhe e diellzimit favorizuan avancimin e fazave fenologjike të kulturave bujqësore dhe rritjen e aktivitetit vegjetativ në të gjithë vendin. Treguesi i shumës së temperaturave aktive mbi pragun biologjik prej 10°C ($\Sigma T.A >10^{\circ}\text{C}$) regjistroi vlera të larta në shumicën e stacioneve meteorologjike, duke konfirmuar vendosjen e plotë të kushteve verore. Në të njëjtën kohë, mungesa e reshjeve dhe rritja e avullimit shtuan kërkesat për ujitje, veçanërisht në zonat me aktivitet intensiv bujqësor.

INTRODUCTION

June 2025 was characterized by typical summer climatic conditions, dominated by high air temperatures, extended sunshine duration, and a pronounced lack of precipitation across most of Albania. During the month, several heatwave episodes were observed, associated with the dominance of the subtropical anticyclone over the Mediterranean region, resulting in temperatures significantly above the long-term climatic average.

At the national scale, the mean air temperature was approximately $+3.8^{\circ}\text{C}$ above the 1961–1990 climatic norm, while maximum temperatures exhibited even greater deviations, with an average anomaly of about $+5.3^{\circ}\text{C}$. The highest values were recorded in the western lowlands and southern regions of the country, where absolute maximum temperatures approached 39°C in some locations.

Atmospheric precipitation showed a substantial deficit, with a negative anomaly of approximately -78.7% compared to the climatic norm. The number of days with precipitation exceeding the 1.0 mm threshold was considerably lower than the long-term average, reflecting the persistence of stable atmospheric conditions and the absence of organized cyclonic systems over the region.

The significant accumulation of heat and the extended duration of sunshine favored the advancement of phenological stages of agricultural crops and enhanced vegetation activity throughout the country. The agrometeorological indicator representing the sum of active temperatures above the biological threshold of 10°C ($\Sigma T.A >10^{\circ}\text{C}$) reached high values at most meteorological stations, confirming the full establishment of summer conditions. At the same time, the lack of rainfall and the increase in evaporation intensified irrigation requirements.

Diellzimi

Muaji qershor 2025 u karakterizua nga vlera relativisht të larta të kohëzgjatjes së diellëzimit, si rezultat i dominimit të kushteve atmosferike të qëndrueshme dhe pranisë së kufizuar të vranësirave gjatë pjesës më të madhe të muajit.

Në figurën Nr. 1 paraqiten vlerat ditore të kohëzgjatjes së diellëzimit, të shprehura në orë, për vendmatjet meteorologjike të Belshit dhe Koplikut. Gjatë muajit, në këto stacione u regjistruan mesatarisht rreth 366 orë. Analiza e ecurisë ditore tregon se pjesa më e madhe e muajit është karakterizuar nga vlera të larta dhe relativisht të qëndrueshme të diellëzimit,

Sunshine duration

The month of June 2025 was characterized by relatively high values of sunshine duration, as a result of the dominance of stable atmospheric conditions and the limited presence of clouds during most of the month.

Figure No. 1 shows the daily values of sunshine duration, expressed in hours, for the meteorological stations of Belsh and Koplík. During the month, an average of about 366 hours were recorded at these stations. Analysis of the daily performance shows that most of the month was characterized by high and relatively stable sunshine values, reflecting low frequency of cloud cover and




Figura Nr.1 / a dhe b – Kohëzgjatja e diellzimit (në orë) për muajin qershor 2025 për vendmatjet meteorologjike Belsh dhe Koplík.

Sunshine duration (in hours) for June 2025 at Belsh dhe Koplík meteorological stations.

duke reflektuar frekuencë të ulët të mbulimit me vranësira dhe mungesë të episodeve të zgjatura me mot të paqëndrueshëm. Devijime nga kjo tendencë vihen re në periudhën 17–20 qershor, kur shtimi i përkohshëm i vranësirave ndikoi në reduktimin e numrit të orëve me diell, fundi i muajit shëni përsëri vlera të larta të diellzimit.

Në figurën Nr.2 paraqitet shpërndarja gjeografike e diellzimit në orë për muajin qershor 2025 sipas Eumetsat, CmSAF. Kushtet e motit me situatë të qëndrueshme dhe pa vranësira solli situatë pothuajse të njëjtë në gjithë vendin ku vlerat lehtëzi më të ulta u monitoruan në pjesën lindore dhe në juglindje të vendit.

lack of prolonged episodes of unstable weather. Deviations from this trend are observed in the period 17–20 June, when a temporary increase in cloud cover affected the reduction of the number of sunny hours, the end of the month marked high sunshine values again.

Figure No.2 shows the geographical distribution of hourly sunshine for the month of June 2025 according to Eumetsat, CmSAF. Weather conditions with clear and cloudless behavior as they should be the same in all light value vendors and monitored in the rest of the eastern and southeastern parts of the country.




Figure 2-Kohëzgjatja e diellzimit për muajin Maj 2025 për Shqipërinë, sipas CmSAF.
Sunshine duration for May 2025 for Albania.
Diellzimi / Sunshine (në orë / in hours), according to CmSAF

Gjatë qershorit 2025, qarkullimi sinoptik në Europë u karakterizua nga ndërveprimi i sistemeve ciklonike atlantike dhe me anticiklon subtropikal mbi Mesdhe. Kalimet frontale sollën periudha vranësirash dhe reshesh në Europën Qendrore dhe Veriore, ndërsa rajonet jugore përjetuan kushte më të qëndrueshme dhe temperatura më të larta, duke reflektuar kalimin gradual drejt regjimit veror, Figura Nr. 3.




Figura Nr. 3 Frontet Atlantike në Europë 3 qershor 2025 Ventusky

Gjatë dekadës së parë të muajit, qarkullimi sinoptik mbi rajonin e Mesdheut u ndikua nga shtrirja graduale e anticiklonit subtropikal nga Afrika e Veriut drejt Mesdheut Qendror dhe Lindor. Kjo strukturë barike favorizoi kushte relativisht të qëndrueshme atmosferike por me prani të madhe të rërës në ajër, Figura Nr. 4 dhe 5




Figura Nr. 4 Presioni atmosferik Mesdhe 5 qershor 2025 Ventusky

Megjithatë, depërtime të dobëta të ajrit më të freskët nga Evropa Qendrore sollën herë pas here paqëndrueshmëri lokale dhe zhvillime konvektive, veçanërisht në zonat bregdetare dhe malore të Mesdheut perëndimor dhe qendror. Në përgjithësi, situata sinoptike pasqyroi një tranzicion gradual drejt kushteve tipike verore në rajon, Figura Nr. 4




Figura Nr. 5 Cilësia e ajrit 10 qershor 2025 Ventusky




Figura Nr. 6 Reshjet 5 qershor 2025 Ventusky

During June 2025, the synoptic circulation over Europe was characterized by the interaction between Atlantic cyclonic systems and the subtropical anticyclone over the Mediterranean. Frontal passages brought periods of cloudiness and precipitation to Central and Northern Europe, while southern regions experienced more stable conditions and higher temperatures, reflecting a gradual transition toward the summer regime, Figure No. 3.

During 1st –10th June, the synoptic circulation over the Mediterranean region was influenced by the gradual expansion of the subtropical anticyclone from North Africa toward the Central and Eastern Mediterranean. This baric structure favored relatively stable atmospheric conditions, but with a significant presence of dust in the air, Figure No. 4 and 5.

However, weak intrusions of cooler air from Central Europe occasionally brought local instability and convective developments, particularly in the coastal and mountainous areas of the western and central Mediterranean. Overall, the synoptic situation reflected a gradual transition toward typical summer conditions in the region, Figure No. 4.

Në të njëjtën periudhë në vendin tonë pati dominim të anticiklonit subtropikal. Ky konfigurim barik favorizoi mot relativisht të qëndrueshëm, me vranësira të pakta dhe temperatura në rritje, duke shënuar valën e parë të nxehtit në vend. Herë pas here, depërtime të dobëta të ajrit më të freskët nga veriu sollën shtim të përkohshëm të vranësirave dhe zhvillime lokale konvektive, veçanërisht në zonat malore, ku ndodhën reshje të dobëta dhe rrufe të izoluara. Ky episod pasqyron ndërveprimin tipik mes qarkullimit anticiklonik subtropikal dhe masave ajrore më të freskëta tipike e muajit qershor, Figura Nr.7.

Gjatë dekadës së dytë, në rajonin e Mesdheut karakteristikë ishte forcimi i anticiklonit subtropikal të shtrirë nga Afrika e Veriut drejt Mesdheut Qendror dhe Lindor. Ky konfigurim barik favorizoi kushte të qëndrueshme atmosferike, me mot kryesisht të kthjellët dhe rritje të temperaturave. Megjithatë, në perëndim të Mesdheut, depërtimet e dobëta të sistemeve frontale nga Europa Perëndimore shkaktuan herë pas here shtim të vranësirave dhe episode të kufizuara paqëndrueshmërie atmosferike, Figura Nr. 8 dhe 9.

During the same period, our country was dominated by the subtropical anticyclone. This baric configuration favored relatively

stable weather conditions, with limited cloudiness and increasing temperatures, marking the first heatwave in the country. Occasionally, weak intrusions of cooler air from the north led to temporary increases in cloud cover and local convective developments, particularly in mountainous areas, where light precipitation and isolated thunderstorms occurred. This episode reflects the typical interaction between subtropical anticyclonic circulation and cooler air masses characteristic of the month of June, Figure No. 7.

During 11th –20th June, the Mediterranean region was characterized by the strengthening of the subtropical anticyclone extending from North Africa toward the Central and Eastern Mediterranean. This baric configuration favored stable atmospheric conditions, with mostly clear weather and increasing temperatures. However, in the western Mediterranean, weak intrusions of frontal systems from Western Europe occasionally caused increased cloudiness and limited

episodes of atmospheric instability, Figure No. 8 and 9.




Figura Nr. 7 Reshjet lokale në Shqipëri 5 qershor 2025 Ventusky




Figura Nr. 8 Presioni i lartë atmosferik 14 qershor 2025 Ventusky




Figura Nr. 9 Depërtimet frontale në Mesdhe 18 qershor 2025 Ventusky

Gjatë së njëjtës periudhë, kushtet sinoptike në Shqipëri u dominuan nga ndikimi i anticiklonit subtropikal të shtrirë mbi Mesdhe. Ky konfigurim barik favorizoi mot të qëndrueshëm, me kthjellime të shumta dhe temperatura relativisht të larta. Prej datave 11-15 qershor vendi përjetori valën e dytë të të nxehtit. Në disa raste pati zhvillime konvektive në orët e pasdites, Figura Nr. 10.




Figura Nr. 10

*Temperaturat në Shqipëri
13 qershor 2025 Ventusky*

Gjatë dekadës së tretë, qarkullimi i masave ajrore mbi rajonin e Mesdheut u karakterizua nga dominimi i anticiklonit subtropikal të shtrirë nga Afrika e Veriut drejt Mesdheut Qendror dhe Lindor. Ky konfigurim barik favorizoi valë të fortë të të nxehtit dhe njëkohësisht rreth 24-25 qershor edhe mase pluhuri sahariane. Në përfundim të rajonit u evidentuan depërtime të dobëta të qarkullimit ciklonik, të cilat sollën shtim të përkohshëm të vranësirave dhe reshje të lokalizuara, Figura Nr. 11.



*Figura Nr. 11 Cilësia e
ajrit nga depërtimi i rërës
24 qershor 2025 Ventusky*




Figura Nr. 12

*Temperaturat në Shqipëri
25 qershor 2025 Ventusky*

Në vendin tonë dominoi anticikloni subtropikal me masa të nxehta ajri, duke shkaktuar një valë të nxehti disa ditore me temperatura maksimale ekstreme. Përveç temperaturave të larta, prezenca e anticiklonit favorizoi konsolidimin e masave të ajrit të thatë, të shoqëruara me grimca pluhuri dhe rëre të transportuara nga shkretëtira Sahariane, Figura Nr. 12.

During the same period, synoptic conditions in Albania were dominated by the influence of the subtropical anticyclone extending over the Mediterranean. This baric configuration favored stable weather, with predominantly clear skies and relatively high temperatures. From 11th–15th June, the country experienced the second heatwave. In some cases, convective developments occurred during the afternoon hours, Figure No 10.

During 21th–31th June, the circulation of air masses over the Mediterranean region was characterized by the dominance of the subtropical anticyclone extending from North Africa toward the Central and Eastern Mediterranean. This baric configuration favored an intense heatwave and, around 24th–25th June, the presence of Saharan dust. In the western part of the region, weak intrusions of cyclonic circulation were observed, bringing temporary increases in cloudiness and localized precipitation, Figure No.11.

In our country, the subtropical anticyclone dominated with hot air masses, causing a multi-day heatwave with extremely high maximum temperatures. In addition to the high temperatures, the presence of the anticyclone favored the consolidation of dry air masses, accompanied by dust and sand particles transported from the Saharan Desert, Figure No. 12.

TEMPERATURAT E AJRIT

Muaji qershor 2025 u karakterizua nga temperatura të ajrit në °C përgjithësisht mbi normën klimatike shumëvjeçare. Në shkallë globale, muaji qershor i vitit 2025 ishte qershori i tretë më i ngrohtë, me një temperaturë mesatare të ajrit sipërfaqësor ERA5 prej 16.46°C, 0.47°C mbi mesataren e viteve 1991-2020. Qershori i vitit 2025 ishte 0.20°C më i ftohtë se qershori rekord i vitit 2024 dhe 0.06°C më i ftohtë se qershori i vitit 2023, i cili ishte i dyti më i ngrohtë.

Temperatura mesatare mbi kontinentin evropian është 1.1°C mbi mesataren e periudhës 1991-2020 për qershorin. Ky është qershori i pestë më i ngrohtë në histori, më i freskët me 0.78°C se qershori më i ngrohtë i vitit 2019.¹

Në figurën Nr.13 a / b paraqiten vlerat e temperaturave dhe anomalitë përkatëse për muajin qershor 2025. Referuar hartës së mëposhtme dhe hartat javore i gjithë rajoni i Europës është me vlera mbi normë. Përfundimisht këtu bën gadishulli skandinav i cili ndodhet në normë.

AIR TEMPERATURES

June 2025 was characterized by air temperatures in °C generally above the multi-year climate norm. On a global scale June 2025 was the third-warmest June globally, with an average ERA5 surface air temperature of 16.46°C, 0.47°C above the 1991-2020 average for June. June 2025 was 0.20°C cooler than the record June of 2024, and 0.06°C cooler than June 2023, which was the second warmest.

Average temperature over the European continent 1.1°C above the 1991-2020 average for June. It ranks the fifth-warmest June in the record, Cooler by 0.78°C than the warmest June in 2019.

Figure No.13 a / b shows the temperature values and the corresponding anomalies for the month of June 2025. Referring to the map below and the weekly maps, the entire region of Europe has values above normal. The exception here is the Scandinavian peninsula, which is at normal.




Figure 13 a / b - Anomalitë e temperaturës së ajrit pranë sipërfaqes për muajin Qershor 2025 kundrejt periudhës 1991÷2020 në shkallë globale dhe për kontinentin Evropian. Surface air temperature anomaly in global scale and for the European continent for June 2025 compared to the period 1991÷2020 (Copernicus, ECMWF, etc.).

Në figurën Nr. 14 paraqitet analiza javore e anomalive të temperaturës së ajrit për muajin qershor. Sipas të dhënave të NOAA, gjatë javës së parë të muajit pjesa më e madhe e Europës është karakterizuar nga anomali pozitive të temperaturës, me vlera

Figure No. 14 presents a weekly analysis of air temperature anomalies for the month of June. According to NOAA data, during the first week of the month most of Europe

¹ <https://climate.copernicus.eu/surface-air-temperature-june-2025>

më të theksuara në Europën Lindore dhe Verilindore. Gjatë javës së dytë vihet re një ndryshim i dukshëm i situatës sinoptike, ku anomalitë negative dominojnë në Europën Lindore dhe Juglindore, ndërsa Europa Perëndimore mbetet kryesisht nën ndikimin e temperaturave mbi normalen klimatike. Në javën e tretë anomalitë pozitive shtrihen pothuajse në të gjithë kontinentin europian, me intensitet më të lartë në Europën Qendrore dhe Lindore. Ndërkohë, gjatë javës së fundit të analizuar, kushtet mbeten

was characterized by positive temperature anomalies, with with more pronounced values in Eastern and Northeastern Europe. During the second week, a significant change in the synoptic situation is observed, where negative anomalies dominate in Eastern and Southeastern Europe, while Western Europe remains mainly under the influence of temperatures above the climate norm, almost throughout the European continent, with higher intensity in Central and Eastern Europe. Meanwhile, during the last week analyzed, conditions remain mainly with temperatures above the climate norm in




Figure 14 - Vlerat e anomalive të temperaturave mesatare të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit qershor 2025, sipas NOAA-s. / Anomaly values of average air temperatures for the European Continent the 4 weeks of June 2025, according to NOAA.

kryesisht me temperatura mbi normalen klimatike në pjesën më të madhe të Europës, megjithëse me intensitet më të moderuar krahasuar me javën paraardhëse.

most of Europe, although with more moderate intensity compared to the previous week.

Figure No. 15 shows the average air temperature values and temperature




Figure 15. - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit dhe anomalive të tyre për kontinentin Europian për muajin Qershor 2025, sipas NOAA-s.

Values of mean air temperatures and their anomalies for the European continent for the month of June 2025, according to NOAA.

Në figurën Nr. 15 paraqiten vlerat mesatare të temperaturës së ajrit dhe anomalitë e temperaturës për muajin qershor 2025 në territorin e Europës. Harta e parë tregon shpërndarjen hapësinore të temperaturave mesatare mujore, ku vlerat më të larta janë regjistruar në pjesën jugore të kontinentit, veçanërisht në rajonin e Mesdheut, ndërsa temperaturat më të ulëta paraqiten në Europën Veriore dhe zonat malore. Ndërkohë, analiza e anomalive të temperaturës sipas NOAA tregon se gjatë muajit qershor 2025 kanë dominuar anomalitë pozitive të temperaturës në pjesën më të madhe të Europës. Devijimet më të theksuara mbi normalen klimatike janë evidentuar në Europën Jugperëndimore dhe në disa zona të Europës Qendrore dhe Lindore. Anomalitë më të moderuara pozitive janë shtrirë edhe në rajonet veriore të kontinentit, ndërsa zonat me anomali negative kanë qenë të kufizuara dhe të izoluara.

anomalies for the month of June 2025 in the territory of Europe. The first map shows the spatial distribution of average monthly temperatures, where the highest values were recorded in the southern part of the continent, especially in the Mediterranean region, while the lowest temperatures are present in Northern Europe and mountainous areas. Meanwhile, the analysis of temperature anomalies according to NOAA shows that during the month of June 2025, positive temperature anomalies dominated in most of Europe. The most pronounced deviations from the climatic normal were evidenced in Southwestern Europe and in some areas of Central and Eastern Europe. The most moderate positive anomalies also extended to the northern regions of the continent, while areas with negative anomalies were limited and isolated.

Bazuar në të dhënat e Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik, të paraqitura në figurën Nr. 16 temperaturat mesatare të ajrit gjatë muajit qershor 2025 janë regjistruar dukshëm mbi normën klimatike të periudhës 1961–1990. Kjo prirje është vërejtur në shumicën e vendmatjeve meteorologjike të vendit, megjithëse me devijime më të moderuara krahasuar me muajt paraardhës. Në nivel kombëtar, temperatura mesatare rezulton rreth +3.8°C mbi normën klimatike, duke konfirmuar kushte përgjithësisht më të ngrohta se mesatarja shumëvjeçare për këtë periudhë.

Based on the data of the National Meteorological Monitoring System, presented in Figure No. 16, the average air temperatures during June 2025 were recorded significantly above the climate norm for the period 1961–1990. This trend was observed in most of the country's meteorological measurement sites, although with more moderate deviations compared to previous months. At the national level, the average temperature results around +3.8°C above the climate norm, confirming generally warmer conditions than the multi-year average for this period.





Figure Nr.16 - Vlerat e temperaturave mesatare të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2025 si dhe ato të normës për Shqipërinë. Values of average air temperatures for some meteorological stations of June 2025.

Analiza mbi ecurinë e temperaturave vijon më tej me figurën Nr. xx, ku paraqiten hartat javore të kontinentit European sipas NOAA për temperaturat maksimale ekstreme të ajrit gjatë muajit qershor 2025 dhe fillimit të korrikut 2025. Rezultatet tregojnë se vlerat më të larta të temperaturave maksimale ekstreme janë regjistruar në pjesën jugore, juglindore dhe jugperëndimore të Europës, veçanërisht në Gadishullin Iberik, rajonin e Mesdheut, Ballkan dhe Turqi, ku temperaturat kanë arritur mbi 35°C dhe lokalisht mbi 40°C. Gjatë javës së parë të muajit, temperaturat më të larta janë përqendruar kryesisht në Europën Jugore dhe Juglindore, ndërsa Europa Qendrore dhe Veriore kanë paraqitur vlera më të moderuara. Në javën

The analysis of temperature trends continues with Figure No. xx, which presents weekly maps of the European continent according to NOAA for extreme maximum air temperatures during June 2025 and early July 2025. The results show that the highest values of extreme maximum temperatures were recorded in the southern, southeastern and southwestern parts of Europe, especially in the Iberian Peninsula, the Mediterranean region, the Balkans and Turkey, where temperatures reached above 35°C and locally above 40°C. During the first week of the month, the highest temperatures were concentrated mainly in Southern and Southeastern Europe, while Central and

e dytë vihet re zgjerim gradual i zonave me temperatura të larta drejt Europës Qendrore dhe Perëndimore.

Northern Europe presented more moderate values. In the second week, a gradual expansion of areas with high temperatures



*Figure 17. - Vlerat e temperaturave maksimale ekstreme të ajrit për kontinentin European për 4 javët e muajit qershor 2025, sipas NOAA-s.
Extreme maximal weekly values of air temperatures for European Continent for 4 weeks of June 2025, according to NOAA.*

Në javën e tretë shfaqet intensifikimi më i dukshëm i temperaturave ekstreme, me përhapje të gjerë të vlerave mbi 30°C në pjesën më të madhe të kontinentit dhe kulme mbi 40°C në rajonet jugore dhe jugperëndimore. Ndërkohë, gjatë javës së fundit të analizuar, kushtet e nxehta vijojnë të dominojnë në Europën Jugore dhe Perëndimore, duke reflektuar vazhdimësinë

towards Central and Western Europe is observed.

The third week saw the most marked intensification of extreme temperatures, with a wide spread of values above 30°C across most of the continent and peaks above 40°C in the southern and southwestern regions. Meanwhile, during the last week analyzed, hot conditions

e një periudhe me temperatura të larta ekstreme në shkallë kontinentale.

Për Shqipërinë, duke iu referuar vrojttimeve meteorologjike dhe përpunimit të bazës së të dhënave, në figurën Nr. 18 paraqitet grafiku me vlerat e temperaturave maksimale të ajrit, të krahasuara me periudhën e normës klimatike. Në shkallë vendi, muaji Qershor 2025 rezultoi rreth +5.3°C mbi normën klimatike, duke u karakterizuar nga temperatura maksimale më të larta se mesatarja shumëvjeçare në shumicën e vendmatjeve meteorologjike të vendit.

continue to dominate in Southern and Western Europe, reflecting the continuation of a period of extreme high temperatures on a continental scale.

For Albania, referring to meteorological observations and database processing, Figure No. 18 presents a graph with the values of maximum air temperatures, compared to the climatic norm period. At the national level, the month of June 2025 resulted around +5.3°C above the climatic norm, being characterized by maximum temperatures higher than the multi-year average in most of the country's meteorological measurement sites.




Figure Nr. 18 - Vlerat e temperaturave maksimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2025 si dhe ato të normës për Shqipërinë.

Values of maximum air temperatures for some meteorological stations of June 2025.

Në figurën Nr. 19 paraqiten hartat javore të NOAA-s për temperaturat minimale ekstreme të ajrit në Europë gjatë muajit qershor 2025 dhe fillimit të korrikut 2025. Analiza tregon se temperaturat minimale ekstreme kanë qenë përgjithësisht më të larta në rajonet jugore dhe mesdhetare të kontinentit, ndërsa Europa Veriore dhe zonat malore janë karakterizuar nga vlera më të ulëta termike gjatë gjithë periudhës së analizuar.

Gjatë javës së parë të muajit, pjesa më e madhe e Europës Qendrore dhe Veriore paraqitet me temperatura minimale relativisht të moderuara, ndërsa rajonet jugore dhe juglindore shfaqin kushte më të ngrohta. Në javën e dytë vihet re një rritje graduale e temperaturave minimale në

Figure No. 19 presents NOAA's weekly maps of extreme minimum air temperatures in Europe during June 2025 and early July 2025. The analysis shows that extreme minimum temperatures have generally been higher in the southern and Mediterranean regions of the continent, while Northern Europe and mountainous areas have been characterized by lower thermal values throughout the analyzed period.

During the first week of the month, most of Central and Northern Europe experiences relatively moderate minimum temperatures, while the southern and southeastern regions experience warmer conditions. The second week sees a gradual increase in minimum temperatures




Figure 19. - Vlerat e temperaturave minimale ekstreme të ajrit për kontinentin Europian për 4 javët e muajit qershor 2025, sipas NOAA-s.

Extreme minimal values of air temperatures for European Continent for 4 weeks of June 2025, according to NOAA.

Europën Jugore dhe Qendrore. Në javën e tretë, kushtet termike bëhen më të qëndrueshme dhe temperaturat minimale më të larta shtrihen në një territor më të gjerë europian. Ndërkohë, gjatë javës së fundit të analizuar, kushtet paraqiten tipike verore, me dominim të temperaturave minimale më të larta në pjesën më të madhe të Europës Jugore, Qendrore dhe Perëndimore, ndërsa veriu i kontinentit dhe zonat malore vijojnë të mbeten relativisht më të freskëta.

in Southern and Central Europe. In the third week, thermal conditions become more stable and the highest minimum temperatures extend over a wider European territory. Meanwhile, during the last week analyzed, conditions appear typically summery, with the dominance of the highest minimum temperatures in most of Southern, Central and Western Europe, while the north of the continent and the mountainous areas continue to remain relatively cooler.

Në figurën Nr. 20 paraqitet grafiku krahasues i vlerave mesatare të temperaturave minimale të ajrit për muajin qershor 2025 në disa nga vendmatjet meteorologjike të Shqipërisë, në raport me normën klimatike shumëvjeçare. Analiza tregon se gjatë këtij muaji temperaturat minimale janë regjistruar mbi normën klimatike pothuajse në të gjitha stacionet meteorologjike të vendit, me një devijim mesatar rreth +2.3°C.

Figure No. 20 presents a comparative graph of the average values of minimum air temperatures for the month of June 2025 at some of the meteorological stations of Albania, in relation to the multi-year climate norm. The analysis shows that during this month the minimum temperatures were recorded above the climate norm at almost all meteorological stations in the country, with an average deviation of about +2.3°C.




Figure Nr.20. - Vlerat e temperaturave minimale të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2025 si dhe ato të normës për Shqipërinë. Values of minimum air temperatures for some meteorological stations of June 2025.

Vlerat më të larta të temperaturave minimale janë evidentuar në zonat bregdetare dhe në ultësirën perëndimore, ndërsa zonat verilindore dhe juglindore kanë regjistruar vlera relativisht më të ulëta. Rritja e temperaturave minimale në krahasim me normalen klimatike reflekton dominimin e kushteve më të ngrohta se mesatarja për periudhën, në përputhje edhe me situatën termike të vërejtur në shkallë rajonale dhe europiane gjatë muajit qershor 2025.


The highest minimum temperature values were recorded in the coastal areas and in the western lowlands, while the northeastern and southeastern areas recorded relatively lower values. The increase in minimum temperatures compared to the climatic normal reflects the dominance of warmer than average conditions for the period, in line with the thermal situation observed at a regional and European scale during June 2025.

Në figurën Nr.21 paraqiten 12 grafikë të ecurisë kohore të temperaturave maksimale, minimale dhe reshjeve përgjatë muajit qershor 2025 për disa nga vendmatjet e Sistemit Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik.

Figure No. 21 presents 12 graphs of the time course of maximum, minimum temperatures and precipitation during the month of June 2025 for some of the measurement sites of the National Meteorological Monitoring System.

Figure .21/1÷21/12 - Temperaturat dhe reshjet ditore për disa vendmatje meteorologjike për muajin qershor 2025 në Shqipëri.

The daily temperatures and precipitation for some meteorological stations for June 2025 in Albania.



Analiza e temperaturave maksimale absolute të ajrit për muajin qershor 2025 paraqitet grafikisht në figurën Nr. 22. Të dhënat tregojnë se gjatë këtij muaji janë regjistruar temperatura maksimale të larta në pjesën më të madhe të vendit, duke reflektuar dominimin e kushteve të ngrohta verore.

The analysis of absolute maximum air temperatures for the month of June 2025 is graphically presented in Figure No. 22. The data show that during this month high maximum temperatures were recorded in most of the country, reflecting the dominance of warm summer conditions.




Figure Nr.22 - Vlerat e temperaturave maksimale absolute të ajrit për disa vendmatjet meteorologjike të muajit qershor 2025 për Shqipërinë.
Values of maximal absolute air temperatures for some meteorological stations of June 2025 for Albania.

Vlerat më të larta janë evidentuar kryesisht në stacionet e ultësirës perëndimore dhe zonat e brendshme të vendit, ku temperaturat maksimale absolute kanë arritur deri në rreth 38–39°C. Ndërkohë, vlera relativisht më të ulëta janë regjistruar në zonat malore dhe verilindore, ku temperaturat maksimale kanë qenë dukshëm më të moderuara.

The highest values have been recorded mainly in the western lowland stations and the interior areas of the country, where the absolute maximum temperatures have reached around 38–39°C. Meanwhile, relatively lower values have been recorded in the mountainous and northeastern areas, where the maximum temperatures have been significantly more moderate.

Shpërndarja hapësinore e këtyre vlerave tregon një variabilitet të dukshëm termik ndërmjet rajoneve të ndryshme të Shqipërisë, i lidhur kryesisht me ndikimin e relievit, lartësisë mbi nivelin e detit dhe depërtimin e masave ajrore të nxehta gjatë periudhës së analizuar.

The spatial distribution of these values shows a significant thermal variability between different regions of Albania, mainly related to the influence of relief, altitude and the penetration of hot air masses during the analyzed period.

Temperaturat minimale absolute të ajrit për muajin qershor 2025 paraqiten në figurën Nr. 23. Analiza tregon se vlerat më të ulëta janë regjistruar kryesisht në vendmatjet meteorologjike të zonave malore dhe verilindore të vendit, ku ndikimi i lartësisë mbi nivelin e detit favorizon kushte më të freskëta termike edhe gjatë sezonit veror.

Vlera minimale absolute më e ulët është regjistruar në vendmatjen Macukull me rreth 6.0°C, ndërsa temperatura relativisht të ulëta janë evidentuar edhe në Kukës, Peshkopi dhe Ersekë. Nga ana tjetër, zonat bregdetare dhe ultësira perëndimore janë karakterizuar nga temperatura minimale më të larta, ku në disa stacione vlerat kanë arritur mbi 14–16°C.

Shpërndarja e temperaturave minimale absolute evidenton kontrastin termik ndërmjet zonave malore dhe atyre bregdetare, duke reflektuar ndikimin e relievit dhe të qarkullimit atmosferik në kushtet termike të vendit gjatë muajit qershor 2025.

The absolute minimum air temperatures for the month of June 2025 are presented in Figure No. 23. The analysis shows that the lowest values were recorded mainly at meteorological stations in the mountainous and northeastern areas of the country, where the influence of altitude above sea level favors cooler thermal conditions even during the summer season.

The lowest absolute minimum value was recorded at the Macukull measuring station with around 6.0°C, while relatively low temperatures were also recorded in Kukës, Peshkopi and Ersekë. On the other hand, the coastal areas and the western lowlands were characterized by higher minimum temperatures, where in some stations the values reached above 14–16°C.

The distribution of absolute minimum temperatures highlights the thermal contrast between mountainous and coastal areas, reflecting the influence of relief and atmospheric circulation on the country's thermal conditions during June 2025.




Figure Nr.23 - Vlerat e temperaturave minimale absolute të ajrit për disa vendmatje meteorologjike të muajit Qershor 2025 për Shqipërinë.
Values of minimal absolute air temperatures for some meteorological stations of June 2025 for Albania.

RESHJET ATMOSFERIKE

Gjatë muajit qershor 2025 reshjet në kontinentin European karakterizuan nga sasi e pakët dhe anomali negative pothuajse në gjithë kontinentin. Sipas publikimeve të NOAA, e paraqitur në figurën Nr.24, lartësia më e madhe e reshjeve ishte në Alpet e Europës ndërsa pjesa tjetër e kontinentit, sidomos ajo verëndimore dhe juglindore ishte me anomali të theksuara negative.

ATMOSPHERIC PRECIPITATION

During the month of June 2025, the European continent was characterized by low rainfall and negative anomalies throughout the continent. According to NOAA publications, this is in Figure No. 24, the highest rainfall was in the European Alps, while the rest of the continent, especially the western and southeastern parts, had pronounced negative anomalies.

Monthly precipitation amounts




Figura Nr.24. - Reshjet për muajin qershor 2025 në kontinentin European dhe anomali të kundrejt periudhës 1981÷2010, sipas NOAA-s. / Rainfall for June 2025 at the European continent and their anomalies referring to the period 1981÷2010 according to NOAA

Lartësia mujore e reshjeve (mm) nga Sistemi Kombëtar të Monitorimit Meteorologjik, paraqiten në figurën Nr.25.

(mm) from the National Meteorological Monitoring System are presented in Figure No.25.




Figura Nr.25. - Lartësia e reshjeve për disa vendmatje meteorologjike të muajin maj 2025 për Shqipërinë.

The amount of precipitations for some meteorological stations of May 2025 for Albania.

Nga analiza e të dhënave për muajin qershor 2025 lartësua e reshjeve ishte në vlerat e normës klimatike 1961-1990 dhe anomali negative prej -78.7%. Kjo situatë e motit pa reshje është karakteristike për stinën e verës, por që nga ana tjetër sjell pasoja sidomos në sektorin bujqësor pasi rrit nevojat për ujtitje.

From the analysis of data for the month of June 2025, the precipitation increase was at the values of the 1961-1990 climate norm and a negative anomaly of -78.7%. This situation of weather without precipitation is characteristic of the summer season, but on the other hand it brings consequences especially in the agricultural sector as it increases the need for irrigation.

Në figurën Nr.26 paraqitet rezultati i numrit mujor të ditëve me reshje mbi pragu 1.0 mm. Gjatë këtij muaji për Shqipërinë janë mesatarisht 81.5 % më pak ditë me reshje

Figure No.26 shows the result of the monthly number of days with precipitation above the 1.0 mm threshold. During this month, there are on average 81.5% fewer days with precipitation for Albania.

Reshjet maksimale 24 orëshe paraqiten në figurën Nr.27.

The maximum 24-hour rainfall is shown in figure No.27.




Figura Nr. 26- Numri i ditëve me reshje për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2024 për Shqipërinë.

The rainy days for some meteorological stations of June 2024 for Albania




Figura Nr. 26 - Lartësia e reshjeve maksimale 24 orëshe (mm) për disa vendmatje meteorologjike të muajit Qershor 2025 për Shqipërinë.

The amount of maximal 24 hours of precipitations (mm) for some meteorological stations of June 2025 for Albania.

Në disa prej stacioneve, konkretisht në Belsh, Dushar dhe Kllojkë janë më shumë se 35 mm. Gjithashtu, nisur nga analiza e reshjeve mujore, në shumë prej vendmatjeve meteorologjike nuk u monitoruan reshje. Edhe jo situatë është karakteristike e stinës, ku nuk mungojnë reshjet orografike me intensitet të lartë në periudha të shkurta kohore.

Në figurën Nr.27 paraqiten imazhet satelitore ditore sipas Eosdis Worldview, ku mbizotërojnë ditët me mot të kthjellët dhe më vranësira të pakta. Sistemet e vranësirave paraqiten të fragmentarizuara ku sjellin kushte për reshje lokale.

In some of the stations, specifically in Belsh, Dushar and Kllojkë, there are more than 35 mm. Also, based on the analysis of monthly precipitation, no precipitation was monitored in many of the meteorological measurement sites. This situation is also characteristic of the season, where there is no lack of orographic precipitation with high intensity in short periods of time.

Figure No.27 shows daily satellite images according to Eosdis Worldview, where days with clear weather and few clouds prevail. Cloud systems appear fragmented, bringing conditions for local precipitation.




Figura Nr. 27 – Pamje satelitore ditore e Shqipërisë sipas EOSDIS WORLDVIEW gjatë muajit qershor 2025.

Daily satellite view of Albania according to EOSDIS WORLDVIEW during June 2025.

AGROMETEOROLOGJI

Muaji qershor 2025 solli kushte agrometeorologjike përgjithësisht të favorshme në territorin e Shqipërisë, të ndikuara nga rritja e temperaturave të ajrit, shtimi i orëve me diell dhe stabiliteti më i madh atmosferik karakteristik për fillimin e verës. Këto kushte ndikuan drejtpërdrejt në intensifikimin e proceseve vegjetative dhe në zhvillimin e shpejtë të kulturave bujqësore, veçanërisht në zonat e ulëta dhe bregdetare të vendit. Akumulimi i lartë i nxehtësisë gjatë muajit favorizoi avancimin e fazave fenologjike të bimëve, etj.

Zonat e ultësirës perëndimore dhe jugore, si Tepelena, Fieri, Durrësi, Orikum dhe Bushati, paraqitën zhvillim më të avancuar të sezonit vegjetativ për shkak të temperaturave më të larta dhe ndikimit të klimës mesdhetare. Në zonat me aktivitet intensiv bujqësor u shtua nevoja për menaxhim më të kujdesshëm të ujitjes dhe monitorim të rezervave ujore në tokë, sidomos për kulturat më të ndjeshme ndaj mungesës së lagështisë.

Gjatë muajit qershor 2025, treguesi agrometeorologjik i shumës së temperaturave aktive mbi pragun biologjik prej 10°C ($\Sigma T.A >10^{\circ}\text{C}$) shfaqti vlera të larta në pothuajse të gjithë territorin e Shqipërisë, duke konfirmuar vendosjen e plotë të kushteve tipike verore dhe rritjen e ndjeshme të potencialit termik për zhvillimin e bimësisë. Rritja e temperaturave mesatare ditore dhe dominimi i motit të qëndrueshëm favorizuan akumulimin intensiv të nxehtësisë, veçanërisht në ultësirën perëndimore dhe zonat jugore të vendit. Shpërndarja hapësinore e këtij treguesi paraqiti kontraste të dukshme ndërmjet zonave bregdetare e të ulëta. Vlerat më të larta u regjistruan në Tepelenë (413.5°C), Durrës (398.7°C), Fier (372.0°C), ku ndikimi i klimës mesdhetare dhe temperaturat e larta gjatë muajit krijuan kushte optimale për zhvillimin intensiv të kulturave bujqësore verore.

AGROMETEOROLOGY

June 2025 brought generally favorable agrometeorological conditions across Albania, influenced by rising air temperatures, increased sunshine duration, and greater atmospheric stability characteristic of the beginning of the summer season. These conditions directly contributed to the intensification of vegetation processes and the rapid development of agricultural crops, particularly in the lowland and coastal areas of the country.

The western and southern lowlands, including Tepelena, Fier, Durrës, Orikum, and Bushat, exhibited a more advanced stage of the vegetation season due to higher temperatures and the influence of the Mediterranean climate. In areas with intensive agricultural activity, the need for more careful irrigation management and monitoring of soil water reserves increased, especially for crops more sensitive to moisture deficiency.

During June 2025, the agrometeorological indicator of the sum of active temperatures above the biological threshold of 10°C ($\Sigma T.A >10^{\circ}\text{C}$) showed high values across almost the entire territory of Albania, confirming the full establishment of typical summer conditions and a significant increase in the thermal potential for vegetation development. The rise in average daily temperatures and the dominance of stable weather conditions favored intensive heat accumulation, particularly in the western lowlands and southern regions of the country.

The spatial distribution of this indicator revealed clear contrasts between the coastal and lowland areas and the mountainous regions. The highest values were recorded in Tepelena (413.5°C), Durrës (398.7°C), and Fier (372.0°C), where the influence of the Mediterranean climate and the high temperatures during the month created optimal conditions for the intensive development of summer agricultural crops.




Figura 28– Vlerat e treguesit të shumës së temperaturave aktive mbi pragun 10.0°C për disa vendmatje meteorologjike të muajit qershor 2025 për Shqipërinë.

The values of the sum of active air temperature above the threshold 10.0°C of some meteorological stations for June 2025 in Albania.

Akumulim i konsiderueshëm i nxehtësisë u evidentua gjithashtu në Petrelë (348.2°C), Koplik (342.5°C), Bësh (344.4°C) dhe Fushë-Krujë (317.3°C), duke treguar ecuri të avancuar të sezonit vegetativ.

Në zonat qendrore dhe verilindore, vlerat e ΣT.A >10°C rezultuan më të moderuara, por sërish të favorshme për aktivitetin vegetativ. Stacione si Peshkopi (302.8°C), Dajt-Reçi (296.8°C), Golaj (276.5°C), treguan nivele të kënaqshme të akumulimit termik, të ndikuara nga relievi dhe lartësia mbi nivelin e detit. Në këto rajone, temperaturat më të buta krahasuar me ultësirën perëndimore ndikuan në një ritëm më të moderuar të zhvillimit të kulturave dhe vegetacionit natyror.

Ndërkohë, stacionet malore vijuan të regjistrojnë vlerat më të ulëta të këtij treguesi. Minimumi u evidentua në Orgjost me 80.3°C, ndërsa vlera të ulëta u regjistruan edhe në Shupenzë (98.3°C), Domgjon (119.5°C), Bilisht (122.5°C). Në këto zona, temperaturat relativisht më të ulëta dhe sezoni vegetativ më i shkurtër kufizojnë akumulimin e nxehtësisë, duke bërë që zhvillimi fenologjik i kulturave të jetë më i vonuar dhe më gradual krahasuar me zonat e ulëta dhe bregdetare (Figura 28).

A considerable accumulation of heat was also observed in Petrelë

(348.2°C), Koplik (342.5°C), Bësh (344.4°C), and Fushë-Krujë (317.3°C), indicating an advanced stage of the vegetation season.

In the central and northeastern regions, ΣT.A >10°C values were more moderate, yet still favorable for vegetation activity. Stations such as Peshkopi (302.8°C), Dajt-Reçi (296.8°C), and Golaj (276.5°C) showed satisfactory levels of thermal accumulation, influenced by the terrain and altitude above sea level. In these regions, milder temperatures compared to the western lowlands contributed to a more moderate pace of crop and natural vegetation development.

Meanwhile, mountainous stations continued to record the lowest values of this indicator. The minimum was observed in Orgjost with 80.3°C, while low values were also recorded in Shupenzë (98.3°C), Domgjon (119.5°C), and Bilisht (122.5°C). In these areas, relatively lower temperatures and a shorter vegetation season limit heat accumulation, causing the phenological development of crops to occur more slowly and gradually compared to the lowland and coastal areas (Figure 28).




Figura 29– Vlerat e avullimit të përlogaritura për muajin qershor 2025
Evaporation values computed for the month June 2025

Muaji qershor 2025 u karakterizua nga një intensifikim i proceseve të avullimit në të gjithë territorin e Shqipërisë, si pasojë e temperaturave të larta të ajrit, rritjes së kohëzgjatjes së insolationit dhe dominimit të kushteve të qëndrueshme atmosferike tipike për fillimin e sezonit veror.

Shpërndarja territoriale e avullimit paraqiti vlera më të larta në zonat bregdetare dhe në ultësirën perëndimore, ku ndikimi mesdhetar dhe temperaturat më të larta krijuan kushte më intensive për avullim. Maksimumi mujor u regjistrua në Tepelena me 77.8 mm, i ndjekur nga Fieri me 75.6 mm, Orikumi me 75.2 mm, Durrësi me 74.8 mm dhe Bushati me 72.2 mm. Vlera të larta u evidentuan gjithashtu në Petrelë (72.0 mm), Kopluk (71.2 mm), dhe Fushë-Krujë (69.2 mm). Në këto rajone, kombinimi i temperaturave të larta dhe aktivitetit intensiv vegjetativ kontribuoi në rritjen e humbjeve të ujit përmes avullimit dhe evapotranspirimit (Figura 29).


Në zonat qendrore dhe verilindore të vendit, avullimi paraqiti vlera mesatare, përgjithësisht ndërmjet 50–65 mm. Stacione si Peshkopi (65.9 mm), Podgori (60.1 mm), Sinjë (63.6 mm), treguan nivele të moderuara të avullimit, të ndikuara nga relievi dhe amplituda më të ulëta termike krahasuar me ultësirën bregdetare.

June 2025 was characterized by an intensification of evaporation processes across the entire territory of Albania, as a

result of high air temperatures, increased sunshine duration, and the dominance of stable atmospheric conditions typical of the beginning of the summer season.

The spatial distribution of evaporation showed higher values in the coastal areas and the western lowlands, where Mediterranean influence and higher temperatures created more favorable conditions for intense evaporation. The monthly maximum was recorded in Tepelena with 77.8 mm, followed by Fier with 75.6 mm, Orikum with 75.2 mm, Durrës with 74.8 mm, and Bushat with 72.2 mm. High values were also observed in Petrelë (72.0 mm), Kopluk (71.2 mm), and Fushë-Krujë (69.2 mm). In these regions, the combination of high temperatures and intensive vegetation activity contributed to increased water losses through evaporation and evapotranspiration (Figure 29).

In the central and northeastern parts of the country, evaporation values were moderate, generally ranging between 50–65 mm. Stations such as Peshkopi (65.9 mm), Podgori (60.1 mm), and Sinjë (63.6 mm) recorded moderate evaporation levels, influenced by the terrain and lower thermal amplitudes compared to the coastal lowlands.



*Figura Nr.30 - Treguesi i vegjetacionit NDVI për muajin qershor 2025.
Vegetation Index NDVI for June 2025.*

Figura 30 paraqet shpërndarjen hapësinore të Indeksit të Diferencës së Normalizuar të Vegjetacionit (NDVI) në Shqipëri gjatë muajit qershor 2025. Hartat tregojnë një mbulesë bimore përgjithësisht të zhvilluar mirë në të gjithë territorin, me dominim të vlerave të larta të NDVI-së, veçanërisht në ultësirën perëndimore, zonat kodrinore dhe rajonet jugore e verilindore të vendit. Këto vlera reflektojnë aktivitet të lartë fotosintetik dhe densitet të shtuar të vegjetacionit gjatë sezonit veror.

Në krahasim ndërmjet dy periudhave të paraqitura në hartë, vërehet një zgjerim dhe intensifikim i zonave me ngjyrë jeshile të errët, duke treguar përmirësim të mëtejshëm të gjendjes së vegjetacionit gjatë muajit. Ultësira perëndimore dhe zonat bujqësore paraqiten me vlera shumë të larta të NDVI-së, si rezultat i temperaturave të favorshme, aktivitetit intensiv vegjetativ dhe zhvillimit të plotë të kulturave bujqësore.

Figure 30 presents the spatial distribution of the Normalized Difference Vegetation Index (NDVI) in Albania during June 2025. The maps indicate generally well-developed vegetation cover across the entire territory, with a predominance of high NDVI values, particularly in the western lowlands, hilly areas, and the southern and northeastern regions of the country. These values reflect high photosynthetic activity and increased vegetation density during the summer season.

A comparison between the two periods shown on the maps reveals an expansion and intensification of the dark green areas, indicating a further improvement in vegetation conditions throughout the month. The western lowlands and agricultural areas display very high NDVI values as a result of favorable temperatures, intensive vegetation activity, and the full development of agricultural crops.

Kliko këtu për të parë këtë buletin ose publikime të ngjashme të vendeve të tjera të botës.



Click here to find this bulletin or similar publications of other countries of the world.

Kliko këtu për të parë këtë buletin ose publikimet e mëparshme.



Click here to find this bulletin or previous publications.



MCB@geo.edu.al

